<p>2.2. në mënyrë të kujdesshme dhe të ndjeshme gjatë gjithë procedurës, duke marrë në konsideratë situatën personale, nevojat, moshën, gjininë, aftësinë e kufizuar dhe nivelin e tyre të pjekurisë, si dhe duke respektuar plotësisht integritetin e tyre fizik, mendor dhe moral, pavarësisht mënyrës që ata kanë rënë në kontakt me procedurën dhe pavarësisht nga statusi dhe cilësia e tyre në procedurë.</p> <p>3. Intervistat, marrjet në pyetje dhe format tjera të hetimit ndaj fëmijës duhet të kryhen nga profesionistë të kualifikuar, të cilët veprojnë në mënyrë të ndjeshme dhe të respektueshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Zbatimi i të drejtës së fëmijës për t'u trajtuar me dinjitet dhe ndjeshmëri</p> <p>1. Për të siguruar trajtim me dinjitet dhe ndjeshmëri në procedurat ku fëmijët përfshihen, subjektet e mëposhtëm marrin në konsideratë:</p> <p>1.1. Gjyqtarët për të mitur, prokurorët për të mitur dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit:</p>	<p>2.2. carefully and sensitively throughout the procedure, taking into account personal situation, needs, age, gender, disability and their level of maturity, as well as fully respecting their physical, mental and moral integrity, regardless of how they have come into contact with the procedure and regardless of their status and quality in the procedure.</p> <p>3. Interviews, interrogations and other forms of inquiry into the child shall be conducted by qualified professionals who proceed in a sensitive and respectful manner.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Exercising the right to be treated with dignity and empathy</p> <p>1. To ensure a dignified and sensitive treatment in procedures involving children, the following subjects shall consider:</p> <p>1.1. Judges for minors, prosecutors for minors and law enforcement officers:</p>	<p>2.2. pažljivo i osetljivo tokom postupka, uzimajući u obzir ličnu situaciju, potrebe, uzrast, pol, invaliditet i nivo zrelosti, kao i potpuno poštovanje njihovog fizičkog, mentalnog i moralnog integriteta, bez obzira na to kako su došli u kontakt sa postupkom i bez obzira na njihov status i svojstvo u postupku.</p> <p>3. Intervjue, ispitivanja i druge oblike istrage o detetu trebaju sprovoditi kvalifikovana stručna lica koji postupaju osetljivo i sa poštovanjem.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Ostvarivanje prava deteta da bude dostojanstveno i osećajno tretirano</p> <p>1. Da bi se obezbedio dostojanstven i osećajan tretman u postupcima koji uključuju decu, u obzir se uzimaju sledeći subjekti:</p> <p>1.1. Da sudije za maloletnike, tužioci za maloletnike i službenici za sprovođenje zakona:</p>
--	---	--

<p>1.1.1. të inkurajojnë krijimin dhe përdorimin e ekipeve multidisiplinare dhe një qasje multidisiplinare ndaj rasteve të fëmijës, duke krijuar njësi të veçanta ligj zbatuese, me përgatitje të posaçme për qëllimin dhe/ose pjesëmarrjen në ekipet multidisiplinare për abuzimet ndaj fëmijës;</p> <p>1.1.2. të nxitin një qasje të përshtatur për fëmijët, duke respektuar të drejtën e tyre për t'u trajtuar me dinjitet, ndjeshmëri dhe kujdes të veçantë;</p> <p>1.1.3. të sigurojnë vendosjen e masave mbrojtëse që, gjithashtu, ruajnë dinjitetin e fëmijës.</p> <p>1.2. Personeli mjekësor dhe mbështetës gjatë ushtrimit të detyrës së tyre duhet që të:</p> <p>1.2.1. nxitin një qasje multidisiplinare duke bashkuar njësi të veçanta me përgatitje të posaçme për këtë qëllim dhe/ose duke u përfshirë në ekipe multidisiplinare për abuzimet ndaj fëmijës;</p> <p>1.2.2. sigurojnë që ekzaminimet mjekësore të kryhen nga një personel me përgatitje të posaçme në një mënyrë që është e përshtatshme për fëmijët dhe</p>	<p>1.1.1. encouraging the establishment and using the multidisciplinary teams and a multidisciplinary approach to child cases, by establishing separate law enforcement units, with special training for the purpose and/or participation in multidisciplinary teams for child abuse;</p> <p>1.1.2. promoting a child-friendly approach, respecting their right to be treated with dignity, sensitivity and special care;</p> <p>1.1.3. ensuring the establishment of protective measures that also preserve the dignity of the child.</p> <p>1.2. Medical and support staff, in the exercise of their duties, shall:</p> <p>1.2.1. promote a multidisciplinary approach by joining separate units with special training for this purpose and/or by getting involved in multidisciplinary teams for child abuse;</p> <p>1.2.2. ensure that medical examinations are carried out by specially trained staff in a manner that is appropriate for the child and that respects the dignity of the</p>	<p>1.1.1. ohrabre uspostavljanje i upotrebu multidisciplinarnih timova i multidisciplinarni pristup slučajevima deteta, uspostavljanjem posebnih jedinica za sprovođenje zakona, sa posebnom obukom u svrhu i/ili učešćem u multidisciplinarnim timovima protiv zlostavljanja dece;</p> <p>1.1.2. podstaknu pristup prilagođen deci, poštujući njihovo pravo da se prema njima postupa dostojanstveno, osetljivo i sa posebnom pažnjom;</p> <p>1.1.3. obezbede uspostavljanje zaštitnih mera, koje takođe čuvaju dostojanstvo deteta.</p> <p>1.2. Medicinsko i pomoćno osoblje u vršenju svojih dužnosti mora da:</p> <p>1.2.1. podstakne multidisciplinarni pristup pridodavanjem posebnih jedinica sa posebnom obukom u tu svrhu i/ili uključivanjem u multidisciplinarnе timove protiv zlostavljanja dece;</p> <p>1.2.2. obezbedi da lekarske preglede obavlja posebno obučeno osoblje, na način koji odgovara detetu i poštuje dostojanstvo deteta, njegovo kulturno i</p>
--	---	--

<p>që respekton dinjitetin e fëmijës, formimin kulturor dhe fetar të tij, si dhe me mbështetjen e nevojshme psikologjike;</p> <p>1.2.3. përpara procedurës penale, të marrë pëlqimin e fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor për ekzaminimin e fëmijës, në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.2.4. sigurojë fshehtësinë e informatave, duke u treguar të ndjeshëm ndaj fëmijës, si dhe duke e ndërprerë ekzaminimin nëse fëmija shfaq shqetësim për të vazhduar;</p> <p>1.2.5. përgatisë fëmijën duke ia shpjeguar dhe duke ia treguar pajisjet, si dhe duke e inkurajuar fëmijën që të bëjë pyetje rreth ekzaminimit.</p> <p>1.3. Profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët duhet që të:</p> <p>1.3.1. nxitin një qasje të përshtatur për fëmijët, duke respektuar dinjitetin dhe të drejtën e tyre për t'u trajtuar me dinjitet, ndjeshmëri dhe kujdes të veçantë;</p>	<p>child, his or her cultural and religious education, as well as the necessary psychological support;</p> <p>1.2.3.before the criminal procedure, obtain the consent of the child and the legal representative for the examination of the child, in accordance with the legislation in force;</p> <p>1.2.4.ensure the confidentiality of information, showing sensitivity to the child, as well as discontinuing the examination if the child is distressed to continue;</p> <p>1.2.5.prepare the child by explaining and showing the equipment, as well as encourage the child to ask questions about the examination.</p> <p>1.3. Professionals working with and for children shall:</p> <p>1.3.1. promote a child-friendly approach, respecting their dignity and their right to be treated with dignity, sensitivity and special care;</p>	<p>versko vaspitanje, kao i potrebnu psihološku podršku;</p> <p>1.2.3. pre krivičnog postupka dobije saglasnost deteta i pravnog zastupnika za pregled deteta, u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.2.4. obezbedi poverljivost podataka, pokazujući osetljivost prema detetu, kao i prekid pregleda, ukoliko je detetu neprijatno da nastavi;</p> <p>1.2.5. pripremi dete objašnjavanjem i pokazivanjem opreme, kao i podsticanje deteta da postavlja pitanja o pregledu.</p> <p>1.3. Stručni radnici koji rade sa i za decu moraju da:</p> <p>1.3.1. podstiču pristup prilagođen deci, poštujući njihovo dostojanstvo i pravo da se prema njima postupa dostojanstveno, osetljivo i sa posebnom pažnjom;</p>
--	---	---

<p>1.3.2. shpjegojnë dhe zbatojnë rëndësinë e trajtimit të fëmijës, me dinjitet dhe ndjeshmëri, për sa i përket përfshirjes së tyre në procedurat gjyqësore dhe administrative;</p> <p>1.3.3. ofrojnë mbështetjen multidisiplinare për fëmijët e përfshirë në procese gjyqësore dhe administrative, si dhe të të përshijnë punonjës socialë dhe të komunitetit;</p> <p>1.3.4. sigurojnë, për gjithë personelin që punon me fëmijët, trajnim për aspektet psiko-sociale të përfshirjes së fëmijës dhe trajtimit të tyre me dinjitet dhe ndjeshmëri;</p> <p>1.3.5. sigurohen që të caktohen zyrtarë mbështetës relevant dhe të trajnuar për ta shoqëruar fëmijën viktimë ose dëshmitar gjatë gjithë procedurës.</p>	<p>1.3.2. explain and apply the importance of treating the child, with dignity and sensitivity, in terms of their involvement in judicial and administrative proceedings;</p> <p>1.3.3. provide multidisciplinary support for children involved in litigation and administrative proceedings, as well as include social and community workers;</p> <p>1.3.4. provide, for all staff working with children, training on the psychosocial aspects of the child involvement and their treatment with dignity and sensitivity;</p> <p>1.3.5. ensure that relevant and trained support officers are appointed to accompany the child victim or witness throughout the proceedings.</p>	<p>1.3.2. objasne i primene značaj dostojanstvenog i osetljivog tretmana deteta, u smislu njihovog učešća u sudskim i upravnim postupcima;</p> <p>1.3.3. pruže multidisciplinarnu podršku deci koja su uključena u sudske i upravne postupke, kao i socijalne radnike i radnike u zajednici;</p> <p>1.3.4. obezbede, za čitavo osoblje koje radi sa decom, obuku o psihosocijalnim aspektima uključivanja dece i njihovom dostojanstvenom i osetljivom tretmanu;</p> <p>1.3.5. obezbede da se imenuju odgovarajući i obučeni službenici za podršku koji će pratiti dete žrtvu ili svedoka tokom čitavog postupka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 E drejta e fëmijës për t'u informuar dhe këshilluar</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 The right of the child to be informed and advised</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Pravo deteta da bude obavešteno i savetovano</p>
<p>1. Nga përfshirja e tyre e parë në procedurë, fëmijët dhe përfaqësuesi i tyre ligjor duhet të informohet menjëherë dhe në mënyrë të duhur, me qëllim që t'i ofrojnë atij</p>	<p>1. From their first involvement in the proceedings, children and their legal representative must be promptly and appropriately informed of the involvement of the child in a proceeding, in order to</p>	<p>1. Od njihovog prvog uključivanja u postupak, deca i njihov zakonski zastupnik, trebaju biti blagovremeno i na odgovarajući način obavešteni, kako bi</p>

<p>mbështetje, dhe ndër të tjera duhet të informohen dhe këshillohen për:</p> <p>1.1. të drejtat e tyre, si dhe instrumentet në dispozicion për të korrigjuar shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre;</p> <p>1.2. sistemin dhe procedurat e përfshira, duke marrë parasysh vendin e veçantë dhe rolin që do të ketë fëmija në procedurë;</p> <p>1.3. mekanizmat ekzistues të mbështetjes për fëmijën kur merr pjesë në procedurë;</p> <p>1.4. përshtatshmërinë dhe pasojat e mundshme të një procesi të caktuar;</p> <p>1.5. akuzat, kur është e zbatueshme;</p> <p>1.6. progresin e përgjithshëm dhe rezultatin e procedurave ose ndërhyrjes;</p> <p>1.7. disponueshmërinë e masave mbrojtëse;</p> <p>1.8. mundësitë ekzistuese për dëmshpërblim;</p>	<p>provide him/her with support, and among other things, shall be informed and advised of:</p> <p>1.1. their rights, as well as the tools available to correct possible violations of their rights;</p> <p>1.2. the system and procedures involved, taking into account the specific place and role that the child will have in the procedure;</p> <p>1.3. existing mechanisms of the child support when participating in the procedure;</p> <p>1.4. the appropriateness and possible consequences of a given process;</p> <p>1.5. charges, when applicable;</p> <p>1.6. overall progress and outcome of proceedings or intervention;</p> <p>1.7. availability of protective measures;</p> <p>1.8. existing compensation options;</p>	<p>mu se pružila podrška, a između ostalog, trebaju bi biti obavješteni i savetovani o:</p> <p>1.1. njihovim pravima, kao i dostupnim alatima za ispravljanje mogućih povreda njihovih prava;</p> <p>1.2. uključenom sistemu i postupcima, uzimajući u obzir specifično mesto i ulogu koju će dete imati u postupku;</p> <p>1.3. postojećim mehanizmima podrške detetu prilikom učešća u postupku;</p> <p>1.4. prikladnostima i mogućnostima posledica određenog postupka;</p> <p>1.5. optužbama, kada je to primenljivo;</p> <p>1.6. ukupnom napretku i ishodu postupka ili intervencije;</p> <p>1.7. dostupnosti zaštitnih mera;</p> <p>1.8. postojećim mogućnostima obeštećenja;</p>
--	---	---

<p>1.9. disponueshmëria e shërbimeve ose organizatave që mund të ofrojnë mbështetje, si dhe mjetet e përdorimit të tyre.</p> <p>2. Informimi dhe këshillimi duhet të bëhet në një mënyrë dhe në një gjuhë që është e përshtatshme për moshën dhe pjekurinë dhe aftësitë e fëmijës dhe nivelin e të kuptuarit dhe në një mënyrë e cila është e ndjeshme ndaj gjinisë dhe kulturës.</p> <p>3. Si fëmija, ashtu edhe përfaqësuesi ligjor duhet të marrin direkt informatën dhe sigurimi i informatave për përfaqësuesin ligjor nuk konsiderohet alternativë për komunikimin e informatës tek fëmija.</p> <p>4. Informimi për çdo akuzë ndaj fëmijës duhet të jepet menjëherë dhe direkt pasi të paraqitet akuza.</p>	<p>1.9. the availability of services or organizations that can provide support, as well as the means of using them.</p> <p>2. Information and counselling should take place in a way and in a language that is appropriate for the age and maturity and abilities of the child and the level of understanding, and in a way that is sensitive to gender and culture.</p> <p>3. The child, and the legal representative shall receive information directly, and providing information to the legal representative is not considered an alternative to communicating information to the child.</p> <p>4. Information on any charges against the child shall be provided immediately and directly after the charge is filed.</p>	<p>1.9. dostupnosti usluga ili organizacija koje mogu pružiti podršku, kao i alata za njihovu upotrebu.</p> <p>2. Obaveštavanje i savetovanje se treba vršiti na način i jezik koji je pogodan starosti, zrelosti, sposobnostima i nivou razumevanja deteta i na način koji je osetljiv na pol i kulturu.</p> <p>3. Kako dete, i roditelj i pravni zastupnik trebaju dobiti direktne informacije, a davanje informacija pravnom zastupniku se ne smatra alternativom prenošenju informacija detetu.</p> <p>4. Informacije o bilo kakvim optužbama protiv deteta trebaju dati odmah i neposredno nakon podnošenja optužbe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Zbatimi i të drejtës së fëmijës për t’u informuar dhe këshilluar</p> <p>1. Për të zbatuar të drejtën për t’u informuar dhe këshilluar, subjektet e mëposhtëm mund të marrin në shqyrtim:</p> <p>1.1. Gjyqtarët për të mitur:</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Exercising the right of the child to be informed and advised</p> <p>1. To exercise the right to be informed and advised, the following subjects shall consider:</p> <p>1.1. Judges for minors:</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Ostvarivanje prava deteta da bude obavješteno i savetovano</p> <p>1. Kako bi se ostvarilo pravo da bude obavješteno i savetovano, u obzir se mogu uzeti sledeći subjekti:</p> <p>1.1. Sudije za maloletnike bi trebale da:</p>

<p>1.1.1. t'u ofrojnë fëmijës informata për procesin gjyqësor dhe përfshirjen e tyre në të, si dhe të sigurojnë që vendimet të jepen në një mënyrë që të mund të kuptohen;</p> <p>1.1.2. të kryejnë monitorimin për të vërtetuar nëse fëmija viktimë dhe dëshmitar ka marrë nga personat e ngarkuar informatën dhe asistencën e duhur në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën dhe t'i përshtatet moshës dhe kapaciteteve të fëmijës për t'u shprehur.</p> <p>1.2. Prokurorët për të mitur t'u ofrojnë fëmijës viktimë dhe dëshmitar apo përfaqësuesve të tyre ligjorë informata përkatëse për asistencën në dispozicion, mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës, ecurinë e çështjes, statusin e të pandehurit, planifikimin e seancave dëgjimore dhe vendimet që jepen, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën, moshën dhe kapacitetet e tij/saj për t'u shprehur.</p> <p>1.3. Zyrtarët e zbatimit të ligjit:</p> <p>1.3.1. të përcaktojnë dhe të përcjellin informatën përkatës për asistencën në</p>	<p>1.1.1. providing the child with information about the litigation and their involvement in it, as well as ensure that decisions are made in a way that can be understood;</p> <p>1.1.2. carry out monitoring to verify that the child victim and witness has received appropriate information and assistance from those in charge, in a way that is appropriate for the child and adapted to the age and capacity of the child to express.</p> <p>1.2. Prosecutors for minors shall provide the child victims and witnesses or their legal representatives with relevant information on available assistance, the chance to address the court, the progress of the case, the status of the defendant, the scheduling of hearings and the decisions rendered, in a manner that is appropriate to the child, his or her age and the capacity to express themselves.</p> <p>1.3. Law enforcement officers shall:</p> <p>1.3.1. determine and convey relevant information on the assistance</p>	<p>1.1.1. daju detetu informacije o sudskom postupku i njihovom učešću u njemu, kao i da obezbede da se odluke donose na razumljiv način;</p> <p>1.1.2. vrše praćenje kako bi se utvrdilo da li su dete žrtva i svedok od nadležnih lica dobili odgovarajuće informacije i pomoć, na način koji je primeren detetu i prilagođen uzrastu i sposobnosti deteta da se izražava.</p> <p>1.2. Tužiocima za maloletnike trebaju dati, deci žrtvama i svedocima ili njihovim pravnim zastupnicima, odgovarajuće informacije o dostupnoj pomoći, mogućnosti da se obrate sudu, napretku predmeta, statusu okrivljenog, zakazivanju ročišta saslušanja i donetim odlukama, na način koji je primeren detetu, njegovoj starosti i sposobnosti da se izražava.</p> <p>1.3. Službenici za sprovođenje zakona bi trebali da:</p> <p>1.3.1. utvrde i prenesu odgovarajuće informacije o pomoći koja je na</p>
---	---	---

<p>dispozicion të fëmijës apo përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës nga ana e tyre, duke filluar nga kontakti i tyre i parë me zyrtarët e zbatimit të ligjit;</p> <p>1.3.2. të sigurojnë që informata t’u jepet sistematikisht fëmijës viktimë dhe dëshmitarë në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën dhe t’i përshtatet moshës dhe kapaciteteve të fëmijës për t’u shprehur.</p> <p>1.4. Mbrojtësi i fëmijës të sigurojnë informata përkatëse për asistencën në dispozicion, mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës, ecurinë e çështjes, statusin e të pandehurit, planifikimin e seancave dëgjimore, vendimet që jepen, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën dhe t’i përshtatet moshës dhe kapaciteteve të fëmijës për t’u shprehur.</p> <p>1.5. Profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët:</p> <p>1.5.1. të përgatisin materiale të përshtatshme për komunikim që të përmbajnë informacion të rëndësishëm për fëmijët dhe t’i shpërndajnë ato përmes rajoneve të policisë, spitaleve, dhomave të pritjes, shkollave,</p>	<p>available to the child or their legal representatives, and the opportunity for them to approach the court, starting with their first contact with law enforcement officers;</p> <p>1.3.2. ensure that information is systematically provided to the child victim and witness in a way that is appropriate for the child and adapted to the age and capacity of the child to express.</p> <p>1.4. Child Advocate shall provide relevant information on the assistance available, the opportunity to approach the court, the progress of the case, the status of the defendant, the scheduling of hearings, the decisions that are made, in a way that is appropriate for the child and adapted to the age and capacity of the child to express.</p> <p>1.5. Professionals working with and for children shall:</p> <p>1.5.1. prepare communication-friendly materials that contain information relevant to children and disseminate them through police stations, hospitals, waiting rooms,</p>	<p>raspolaganju detetu ili njihovim pravnim zastupnicima i mogućnosti da se obrate sudu, počevši od prvog kontakta sa službenicima za sprovođenje zakona;</p> <p>1.3.2. obezbede da se detetu žrtvu i svedoku sistematski daju informacije na način koji je primeren detetu i prilagođen uzrastu i sposobnosti deteta da se izražava.</p> <p>1.4. Branilac deteta bi trebao dati odgovarajuće informacije o dostupnoj pomoći, mogućnosti da se obrati sudu, napretku predmeta, statusu okrivljenog, zakazivanju ročišta saslušanja, odlukama koje su donete, na način primeren detetu i prilagođen uzrastu i sposobnosti deteta da se izražava.</p> <p>1.5. Stručni radnici koji rade sa i za decu treba da:</p> <p>1.5.1. pripreme odgovarajuće materijale za komunikaciju, koji sadrže važne informacije za decu i da ih raspodele putem regiona policije, bolnica, čekaonica, škola, socijalnih službi, javnih kancelarija i interneta;</p>
--	---	--

<p>shërbimeve sociale, zyrave publike dhe internetit;</p> <p>1.5.2. mundësisht, të ndjekin çështje individuale ku fëmijët përfshihen si dëshmitarë ose viktime dhe të sigurojnë që fëmijët të kenë mundësi të marrin informatën që është i përshtatshëm për ta;</p> <p>1.5.3. të integrojnë nxitjen e mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës në objektivat e programit dhe të organizojnë sensibilizimin e fëmijës dhe komuniteteve të tyre për çështje që lidhen me mekanizma të ndryshëm të drejtësisë;</p> <p>1.5.4. të ofrojnë fëmijës apo përfaqësuesve të tyre ligjorë, informata përkatëse për asistencën në dispozicion, mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës, ecurinë e çështjes, statusin e të pandehurit, planifikimin e seancave dëgjimore, vendimet që jepen, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën, moshën dhe kapacitetet e tij/saj për t'u shprehur.</p>	<p>schools, social services, public offices and the Internet;</p> <p>1.5.2. preferably, pursue individual cases where children are involved as witnesses or victims and ensure that children have access to information that is appropriate for them;</p> <p>1.5.3. integrate the possibility of approaching the court in the objectives of the program and organize the awareness-raising of the child and their communities on issues related to various justice mechanisms;</p> <p>1.5.4. provide the child or their legal representatives with relevant information on the assistance available, the opportunity to approach the court, the progress of the case, the status of the defendant, the scheduling of hearings, the decisions made, in a way that is appropriate for the child, his/her age and the capacity to express himself/herself.</p>	<p>1.5.2. po mogućnosti, vode pojedinačne slučajeve kada su deca uključena kao svedoci ili žrtve i obezbede da deca imaju pristup informacijama koje su za njih prikladne;</p> <p>1.5.3. integrišu mogućnost obraćanja sudu u ciljevima programa i organizuju podizanje svesti deteta i njihovih zajednica o pitanjima koja se odnose na razne pravosudne mehanizme;</p> <p>1.5.4. daju deci ili njihovim pravnim zastupnicima odgovarajuće informacije o dostupnoj pomoći, mogućnosti da se obrate sudu, napretku predmeta, statusu okrivljenog, zakazivanju ročišta saslušanja, donetim odlukama, na način koji je primeren detetu i prilagođen uzrastu i sposobnosti deteta da se izražava.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 16</p> <p align="center">E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet</p>	<p align="center">Article 16</p> <p align="center">The right of the child to be heard and to express views and concerns</p>	<p align="center">Član 16</p> <p align="center">Pravo deteta da bude saslušano i da izrazi stavove i zabrinutosti</p>
<p>1. Fëmija ka të drejtë për t'u dëgjuar në procedurë, dhe ka të drejtën që t'i shprehë pikëpamjet, opinionet dhe bindjet e veta lirisht, pa presion dhe manipulim, në respekt të personalitetit të tij, dhe që pikëpamjet t'i merren në konsideratë dhe t'u jepet peshë sipas aftësive, moshës, pjekurisë intelektuale dhe aftësisë së tij për t'u shprehur.</p> <p>2. Kur fëmija merr iniciativën për t'u dëgjuar brenda një çështje që prek atë, dëgjimi i tij nuk duhet refuzuar, përveç nëse është në interesin më të mirë të fëmijës.</p> <p>3. Fëmija duhet të merr të gjitha informacionet e rëndësishme lidhur me procedurën, si dhe i duhet mundësuar të shpreh shqetësimet e tij, si dhe t'i shpjegohen arsyet kur këto shqetësime nuk merren parasysh.</p> <p>4. Të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve ligjorë të fëmijës duhen respektuar, për ta drejtuar fëmijën në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të fëmijës.</p>	<p>1. The child has the right to be heard in the proceedings, and has the right to express his or her views, opinions and beliefs freely, without pressure or manipulation, in respect of his or her personality, and to have his or her views taken into account and weighted according to his or her abilities, age, intellectual maturity and ability to express himself/herself.</p> <p>2. When the child takes the initiative to be heard for a matter that affects him/her, his/her hearing shall not be refused, unless it is in the best interest of the child.</p> <p>3. The child shall receive all the important information related to the procedure, as well as be able to express his/her concerns, as well as to explain the reasons when these concerns are not taken into account.</p> <p>4. The rights and obligations of the legal representatives of the child must be respected, in order to guide the child in the exercise of his/her right, in accordance with the development of the child's abilities.</p>	<p>1. Dete ima pravo da bude saslušano u postupku i ima pravo da slobodno, bez pritiska i manipulacija, izrazi svoje stavove, mišljenja i uverenja u pogledu svoje ličnosti i da se njegovi stavovi uzmu u obzir i prida težina prema njegovim sposobnostima, starosti, intelektualnoj zrelosti i sposobnosti da se izražava.</p> <p>2. Kada dete preuzme inicijativu da bude saslušano u vezi sa nekim pitanjem koje se tiče njega, njegovo saslušanje ne bi trebalo odbiti, izuzev ukoliko to nije u najboljem interesu deteta.</p> <p>3. Dete treba da dobije sve važne informacije u vezi sa postupkom, kao i da bude u stanju da izrazi svoju zabrinutost i objasni razloge kada se te zabrinutosti ne uzimaju u obzir.</p> <p>4. Prava i obaveze pravnih zastupnika deteta se moraju poštovati, kako bi se dete usmerilo ka ostvarivanju svog prava, u skladu sa razvojem detetovih sposobnosti.</p>

<p>5. Aktgjykimet dhe vendimet që prekin fëmijët duhet të jenë të rregullta, të arsyetuar dhe në gjuhë të përshtatshme, veçanërisht ato në të cilat pikëpamjet e fëmijës nuk janë ndjekur.</p> <p>6. Fëmija gjatë intervistës duhet të flasë lirshëm, pa frikë, pa ndërprerje të pajustificueshme, dhe si dhe asnjë person tjetër nuk duhet të lejohet në dhomën e intervistës.</p> <p>7. Procedura e dëgjimit të fëmijës duhet të jetë transparente dhe informuese, miqësore ndaj fëmijës, i realizuar nga një staf i trajnuar dhe kur është e mundur pa formalitete, siç është uniforma zyrtare.</p>	<p>5. Judgments and decisions affecting children should be orderly, reasoned and in an appropriate language, especially those in which the views of the child have not been followed.</p> <p>6. During the interview, the child shall speak freely, without fear, without unjustifiable interruptions, and no other person shall be allowed in the interview room.</p> <p>7. The child's hearing procedure shall be transparent and informative, child-friendly, performed by trained staff, and where possible, without formalities, such as a formal uniform.</p>	<p>5. Presude i odluke koje se tiču dece trebaju biti uredne, obrazložene i na odgovarajućem jeziku, posebno one u kojima se ne slede stavovi deteta.</p> <p>6. Tokom razgovora, dete bi trebalo da razgovara slobodno, bez straha, bez neopravdanih prekida i nijedna druga osoba ne sme biti dozvoljena u sobu za razgovore.</p> <p>7. Postupak saslušanja deteta bi trebao da bude transparentan i informativan, prilagođen deci, sproveden od strane obučenog osoblja i, kada je to moguće, bez formalnosti, kao što je službena uniforma.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Zbatimi i të drejtës së fëmijës për t’u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Exercising the right of the child to be heard and to express views and concerns</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Ostvarivanje prava deteta da bude saslušano i da izrazi stavove i zabrinutosti</p>
<p>1. Për të zbatuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet në procedurë, subjektet e mëposhtëm mund të marrin në shqyrtim:</p> <p>1.1. Gjyqtarët për të mitur të monitorojnë nga afër mënyrën si u drejtohen palët fëmijës, të sigurojnë që të përdoret gjuha e përshtatshme dhe t’u mundësohet</p>	<p>1. To exercise the right to be heard and to express views and concerns in each procedure, the following subjects shall consider:</p> <p>1.1. Judges for minors shall closely monitor the manner in which the parties approach children, and ensure that appropriate language is used and enable</p>	<p>1. Kako bi se ostvarilo pravo na saslušanje i izražavanje stavova i zabrinutosti u svakom postupku, u obzir se mogu uzeti sledeći subjekti:</p> <p>1.1. Sudije za maloletnike treba da pažljivo prate način na koji strane pristupaju deci i obezbede da se koristi odgovarajući jezik i omogući deci da</p>

<p>fëmijëve për të shprehur lirisht pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre;</p> <p>1.2. Zyrtarët e zbatimit të ligjit:</p> <p>1.2.1. të jenë të vëmendshëm ndaj pikëpamjeve, shqetësimeve dhe nevojave që mund të shprehen nga fëmijët gjatë kontakteve të tyre me zyrtarët e zbatimit të ligjit, duke i'u përgjigjur pozitivisht sa herë që është e mundur dhe duke dhënë shpjegime, në një gjuhë të kuptueshme për fëmijën, pse disa pikëpamje, kërkesa apo pritshmëri merren në konsideratë dhe të tjerat jo;</p> <p>1.2.2. ta bëjnë trajnimin për komunikimin me fëmijët të detyrueshëm për zyrtarët e zbatimit të ligjit që merren me këtë kategori.</p> <p>1.3. Mbrojtësit e fëmijës: të verifikojnë pikëpamjet, shqetësimet, pritshmëritë dhe nevojat e fëmijës, duke ua përcjellë këto autoriteteve përkatëse, si dhe duke i shpjeguar fëmijës se çfarë mund të pritet logjikisht nga përfshirja e tij/saj në procesin gjyqësor.</p> <p>1.4. Prokurorët për të mitur:</p>	<p>children to express their views and concerns freely;</p> <p>1.2. Law enforcement officers:</p> <p>1.2.1. being attentive to the views, concerns and needs that children may express during their contact with law enforcement officers, responding positively whenever possible and explaining, in a language understandable to the child, why certain views, demands or expectations are taken into account and others not;</p> <p>1.2.2. make training for communicating with children compulsory for law enforcement officers dealing with this category.</p> <p>1.3. Child advocates shall verify the views, concerns, expectations and needs of the child, while conveying these to respective authorities, as well as explaining what the child can reasonably expect from his/her involvement in the judicial process.</p> <p>1.4. Prosecutors for minors:</p>	<p>slobodno izražavaju svoje stavove i zabrinutosti;</p> <p>1.2. Službenici za sprovođenje zakona treba da:</p> <p>1.2.1. budu pažljivi u pogledu stavova, zabrinutosti i potreba koje deca mogu izraziti tokom svog kontakta sa službenicima za sprovođenje zakona, pozitivno reagujući, kad god je to moguće, i objašnjavajući detetu na razumljiv jezik zašto se određeni stavovi, zahtevi ili očekivanja uzimaju u obzir, a drugi ne ;</p> <p>1.2.2.završe obuku za komunikaciju sa decom obaveznom za službenike za sprovođenje zakona koji se bave ovom kategorijom.</p> <p>1.3. Branilac deteta treba da proveri stavove, zabrinutosti, očekivanja i potrebe deteta, istovremeno ih prenoseći odgovarajućim organima i objašnjavajući šta dete može razumno očekivati od svog učešća u pravosudnom postupku.</p> <p>1.4. Tužioc i za maloletnike bi trebali da:</p>
--	--	--

<p>1.4.1. të krijojnë praktikën e marrjes dhe paraqitjes së deklaratave të viktimës ose procedurave të barasvlershme për të dëgjuar mendimet e fëmijës dhe të familjeve të tyre;</p> <p>1.4.2. të nxisin procese gjyqësore, në të cilat fëmijët viktimë mund të shprehin pikëpamjet e tyre dhe mund të dëgjojnë për dëmin që kanë pësuar.</p> <p>1.5. Profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët duhet të bëjnë përpjekjet për të bërë të mundur që fëmijët të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procedurë, duke siguruar që fëmijës:</p> <p>1.5.1. t'u merret mendimi për çështjet e parashtruara;</p> <p>1.5.2. t'i jepen këshilla për çështjet e ngritura;</p> <p>1.5.3. t'i jepet mundësia për të shprehur lirisht dhe në mënyrën e tyre, pikëpamjet dhe shqetësimet për përfshirjen e tyre në procedurë, shqetësimet e tyre për sigurinë lidhur me të akuzuarin, mënyrën në të cilën ata parapëlqejnë që të japin dëshmi dhe</p>	<p>1.4.1. establishing the practice of receiving and presenting victim statements or equivalent procedures to hear the opinions of children and their families;</p> <p>1.4.2. promoting litigation in which child victims can express their views and be heard about the harm they have suffered.</p> <p>1.5. Professionals working with and for children shall make efforts to make it possible for children to express their views and concerns regarding their participation in the proceeding, ensuring that the child:</p> <p>1.5.1. is consulted on the issues raised;</p> <p>1.5.2. is given advice on the issues raised;</p> <p>1.5.3. is given the opportunity to express freely and in their own way, the views and concerns about their involvement in the proceedings, their own security concerns about the accused, the way in which they prefer to testify, and their feelings about the outcome of the process;</p>	<p>1.4.1. uspostave praksu primanja i iznošenja izjava žrtava ili ekvivalentnih postupaka, kako bi se čulo mišljenje dece i njihovih porodica;</p> <p>1.4.2. podstaknu sudske procese u kojima deca žrtve mogu izraziti svoje stavove i biti saslušana o šteti koju su pretrpela.</p> <p>1.5. Stručni radnici koji rade sa decom i za decu trebaju uložiti napore kako bi omogućili deci da izraze svoje stavove i zabrinutosti u vezi sa svojim učešćem u postupku, obezbeđujući da:</p> <p>1.5.1. se od dece dobijaju mišljenja o pokrenutim pitanjima;</p> <p>1.5.2. im se daju saveti o pokrenutim pitanjima;</p> <p>1.5.3. im daju mogućnost da slobodno i na svoj način izraze stavove i zabrinutosti zbog njihovog učešća u postupku, njihove zabrinutosti o bezbednosti u vezi sa optuženim, načina na koji će dati svedočenja i njihove osećaje o ishodu postupka;</p>
---	---	---

<p>ndjenjat e tyre për përfundimet e procesit;</p> <p>1.5.4. t'i jepet konsideratë e duhur pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre dhe, nëse nuk janë gjendje që të veprojnë kështu, t'ia shpjegojnë arsyet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 E drejta e fëmijës për privatësi</p> <p>1. Në procedurë, fëmija ka të drejtë për mbrojtjen dhe respektimin e jetës së tij private, familjare, banesës, korrespondencës dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin dhe dinjitetin e fëmijës.</p> <p>2. Asnjë informacion nuk mund të publikohet, i cili mund të çojë në identifikimin e fëmijës, përveç në raste të jashtëzakonshme kur fëmija mund të përfitojë nëse çështja zbulohet ose publikohet.</p> <p>3. Nëse transferimi i të dhënave personale dhe të ndjeshme për fëmijën është i nevojshëm, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, institucionet përkatëse duhet të rregullojnë këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës.</p>	<p>1.5.4. is given due consideration for their views and concerns and, if they are unable to do so, explain the reasons.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 The right of the child to privacy</p> <p>1. In the procedure, the child shall have the right to the protection and respect of his or her private life, family, home, correspondence and shall be protected from malicious, arbitrary, and unlawful interference with the child's morality and dignity.</p> <p>2. No information may be published, which may lead to the identification of the child, except in exceptional cases where the child may benefit if the matter is discovered or published.</p> <p>3. If the transfer of personal and sensitive data about the child is necessary, taking into account the best interest of the child, the relevant institutions shall regulate this transfer in accordance with the relevant legislation.</p>	<p>1.5.4. pravilno uzmu u obzir njihovi stavovi i zabrinutosti i, ukoliko to nisu u stanju da to učine, da im se objasne razlozi.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Pravo deteta na privatnost</p> <p>1. U postupku, dete ima pravo na zaštitu i poštovanje svog privatnog života, porodice, doma, prepiske i mora biti zaštićeno od zlonamernog, proizvoljnog i nezakonitog mešanja u detetov moral i dostojanstvo.</p> <p>2. Ne smeju se objavljivati informacije koje mogu dovesti do identifikacije deteta, izuzev u izuzetnim slučajevima kada dete može imati koristi ukoliko se predmet otkrije ili objavi.</p> <p>3. Ukoliko je potreban prenos ličnih i osetljivih podataka o detetu, uzimajući u obzir najbolji interes deteta, nadležne institucije bi trebale da uredе taj prenos u skladu sa odgovarajućim zakonodavstvom.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 19 Zbatimi i të drejtës së fëmijës për privatësi</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Exercising right of the child to privacy</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Ostvarivanje prava deteta na privatnost</p>
<p>1. Për të zbatuar të drejtën e fëmijës për privatësi, subjektet e mëposhtëm mund të marrin në shqyrtim:</p> <p>1.1.gjyqtarët për të mitur duhet të respektojnë fshehtësinë e informacionit për fëmijët, sipas rastit, të mbrojnë fshehtësinë e informacionit lidhur me fëmijët, duke urdhëruar përjashtimin e plotë të publikut dhe të mbajnë seancë me dyer të mbyllura;</p> <p>1.2.prokurorët për të mitur duhet të respektojnë fshehtësinë e informacionit për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të veprës penale, të kërkojnë marrjen e masave për mbrojtjen e identitetit të fëmijës viktimë ose dëshmitar, në rast se këto masa nuk zbatohen automatikisht, si dhe të ndjekë penalisht median nëse shkelet e drejta e fëmijës për sa i takon jetës private apo fshehtësisë së informacionit.</p> <p>1.3.profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët duhet të respektojnë rregullat e rrepta të konfidencialitetit, t'i mbajnë dokumentet që bëjnë publik të dhënat për</p>	<p>1. To exercise the right of the child to privacy, the following subjects may take into consideration:</p> <p>1.1. judges for minors shall respect the privacy of children, as appropriate, protect the confidentiality of information about children by ordering the complete exclusion of the public and hold a closed-door hearing;</p> <p>1.2. prosecutors for minors shall respect the confidentiality of information about child victims and witnesses of the crime, request that measures be taken to protect the identity of the child victim or witness, in case these measures are not implemented automatically, and prosecute the media if the child's right to privacy or confidentiality of information is infringed.</p> <p>1.3. professionals working with and for children must abide by strict confidentiality rules, keep documents</p>	<p>1. Za ostvarivanje prava deteta na privatnost, u obzir se mogu uzeti sledeći subjekti:</p> <p>1.1. sudije za maloletnike moraju poštovati privatnost dece, prema potrebi, zaštititi poverljivost podataka o deci nalažući potpuno isključenje javnosti i održavanje saslušanja iza zatvorenih vrata;</p> <p>1.2. tužioci za maloletnike moraju poštovati poverljivost podataka o deci žrtvama i svedocima zločina, zahtevati preduzimanje mera za zaštitu identiteta deteta žrtve ili svedoka, u slučaju da se te mere ne sprovede automatski, i kazneno goniti medije, ukoliko se detetu povredi pravo na privatnost ili poverljivost podataka.</p> <p>1.3. stručni radnici koji rade sa i za decu moraju se pridržavati strogih pravila poverljivosti, čuvati dokumente</p>

<p>fëmijën në vend të sigurt dhe mos t'ia bëjnë të ditur këtë informacion askujt, pa qenë paraprakisht të autorizuar;</p> <p>1.4. mediat duhet të miratojnë dhe zbatojnë masa vetërregulluese për të mbrojtur fshehtësinë e informacionit dhe të dhënat personale të viktimës. Në pajtim me këtë udhëzim administrativ dhe legjislacionin në fuqi, mbrojtja e privatësisë së fëmijës duhet të përcaktohet në Kodin e Etikës të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, që përfshinë por nuk kufizohet në:</p> <p>1.4.1. dhënien e anonimitetit ose e një pseudonimi, përdorimin e ekraneve ose zërave maskues, fshirjen e emrave dhe elementeve të tjerë që mund të çojnë në identifikimin e një fëmije nga të gjitha dokumentet, duke ndaluar çdo formë të regjistrimit si foto, audio apo video,</p> <p>1.4.2. mbrojtjen e të dhënave personale, që përfshijnë por nuk kufizohen në procedura disiplinore, regjistrimi i rasteve të dhunës, trajtimi mjekësor në shkollë, orientimi shkollor, arsimi special për personat me aftësi të</p>	<p>that make the child's information public in a safe place, and not disclose this information to anyone without prior authorization.;</p> <p>1.4. the media shall adopt and implement self-regulatory measures to protect the confidentiality of information and personal data of the victim. In accordance with this Administrative Instruction and the legislation in force, the protection of the privacy of the child must be defined in the Code of Ethics of the Independent Media Commission and the Press Code of Kosovo, which includes but is not limited to:</p> <p>1.4.1. anonymization or giving a nickname, using screens or masking voices, deleting names and other elements that may lead to identifying a child from all documents, prohibiting any form of recording as photo, audio, or video,</p> <p>1.4.2. protection of personal data, including but not limited to disciplinary proceedings, registration of cases of violence, medical treatment at school, school orientation, special education for persons with disabilities</p>	<p>koji čine detetove informacije javnim na sigurnom mestu i ne smeju ih otkrivati nikome bez prethodnog odobrenja;</p> <p>1.4. mediji bi trebali usvojiti i sprovoditi sopstvene regulativne mere kako bi zaštitili poverljivost informacija i ličnih podataka žrtve. U skladu sa ovim Administrativnim uputstvom i važećim zakonodavstvom, zaštita privatnosti deteta mora biti definisana Etičkim kodeksom Nezavisne komisije za medije i Kodeksom za štampu Kosova, koji uključuje, ali nije ograničen na:</p> <p>1.4.1. davanje anonimnosti ili nadimka, korišćenje ekrana ili maskiranje glasova, brisanje imena i drugih elemenata koji mogu dovesti do identifikacije deteta iz svih dokumenata, zabrana bilo kog oblika snimanja kao što je fotografija, audio ili video zapis,</p> <p>1.4.2. zaštita ličnih podataka, uključujući, ali ne ograničavajući se na disciplinske postupke, registraciju slučajeva nasilja, lečenje u školi, školsku orijentaciju, specijalno obrazovanje za osobe sa invaliditetom</p>
---	---	---

<p>kufizuara dhe ndihma sociale për nxënësit nga familjet e varfëra.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 E drejta e fëmijës për siguri</p> <p>1. Fëmija gjatë procedurës ose proceseve të tjera të ndërlidhura duhet të mbrohet nga dëmtimi, përfshirë frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi sekondar.</p> <p>2. Masa të posaçme parandaluese duhet të zbatohen për fëmijët kur kryesi i pretenduar është prindi, anëtari i familjes ose kujdestari.</p> <p>3. Profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët, duhet që të njoftojnë autoritetet përkatëse, nëse dyshojnë se fëmija viktimë ose dëshmitar është dëmtuar, po dëmtohet apo ka gjasa që të dëmtohet.</p> <p>4. Kur fëmija mund të jetë objekt kanosjeje, kërcënimi ose dëmtimi, duhet të krijohen kushtet e përshtatshme për të garantuar sigurinë e fëmijës, përmes marrjes së masave si:</p> <p>4.1. shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë mes fëmijës viktimë dhe dëshmitarë dhe autorëve të veprave penale gjatë procedurës;</p>	<p>and social assistance for students from poor families.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 The right of the child to security</p> <p>1. The child shall be protected from harm during the procedure or other related processes, including intimidation, retaliation and secondary victimization.</p> <p>2. Particular precautionary measures shall apply to children when the alleged perpetrator is a parent, a member of the family or a guardian.</p> <p>3. Professionals who work with and for children must notify the relevant authorities if they suspect that a child victim or witness has been harmed, is being harmed or is likely to be harmed.</p> <p>4. Where children may come into contact with intimidation, threats or harm, appropriate conditions must be established to ensure the safety of the child, by taking measures such as:</p> <p>4.1. avoiding direct contact between the child victim and witnesses and perpetrators during the proceedings;</p>	<p>i socijalnu pomoć učenicima iz siromašnih porodica.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Pravo deteta na bezbednost</p> <p>1. Dete treba zaštititi od štete tokom postupka ili drugih srodnih procesa, uključujući zastrašivanje, odmazdu i sekundarnu viktimizaciju.</p> <p>2. Posebne mere predostrožnosti se trebaju primeniti na decu kada je navodni počinitelj roditelj, član porodice ili staratelj.</p> <p>3. Stručni radnici koji rade sa i za decu moraju obavestiti nadležne organe ukoliko sumnjaju da je dete žrtva ili svedok povređeno, oštećeno ili je verovatno da će biti oštećeno.</p> <p>4. Kada dete može biti predmet zastrašivanja, pretnje ili oštećenja, moraju se uspostaviti odgovarajući uslovi da se osigura bezbednost deteta, preduzimanjem mera kao što su:</p> <p>4.1. izbegavanje direktnog kontakta između deteta žrtve i svedoka i učinilaca krivičnih dela tokom postupka;</p>
--	---	--

<p>4.2. të lëshohen nga gjykata urdhra për kufizim lëvizjeje;</p> <p>4.3. të urdhërohet paraburgimi i të akuzuarit dhe të vendosen kushte të veçanta garancie për “kufizimin e të gjithë kontakteve” për lirim me kusht;</p> <p>4.4. të jepet masa e arrestit shtëpiak për të pandehurin;</p> <p>4.5. kur është e mundur dhe e nevojshme, t’u ofrohet fëmijës viktimë dhe dëshmitarë mbrojtje nga policia ose nga Organi i Kujdestarisë, në partneritet me subjektet tjera publike dhe private që ofrojnë mbrojtje dhe strehim dhe të mos bëhet publike vendndodhja e tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Zbatimi i të drejtës së fëmijës për siguri</p> <p>1. Për të mundësuar sigurinë e fëmijës në procedurë subjektet e mëposhtme duhet të konsiderojnë:</p> <p>1.1. Gjyqtari për të mitur duhet që:</p>	<p>4.2. issuing restriction orders by the court;</p> <p>4.3. ordering the detention of the accused and imposing particular conditions of guarantee on "limiting all contacts" on bail;</p> <p>4.4. issue an order for home detention for the defendant;</p> <p>4.5. where possible and necessary, provide child protection and witness protection to the child by the police or the Custodian Body, in partnership with other public and private entities providing protection and shelter, and not disclose their whereabouts.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Exercising the right of the child to security</p> <p>1. In order to enable the safety of the child in the procedure, the following subjects shall consider:</p> <p>1.1. The judge for minors:</p>	<p>4.2. izdavanje naloga za ograničenje kretanja od strane suda;</p> <p>4.3. da se naloži pritvor optuženom i nametanje posebnih uslova garancije za „ograničavanje svih kontakata” za uslovno oslobađanje;</p> <p>4.4. izdavanje mera za kućni pritvor za okrivljenog;</p> <p>4.5. tamo gde je to moguće i potrebno, pružiti zaštitu deteta žrtve i svedoka od strane policije ili starateljskog tela, u partnerstvu sa drugim javnim i privatnim subjektima koji pružaju zaštitu i sklonište, i ne otkrivati njihovo prebivalište.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Ostvarivanje prava deteta na bezbednost</p> <p>1. Da bi se omogućila bezbednost deteta u postupku, u obzir se mogu uzeti sledeći subjekti:</p> <p>1.1. Sudija za maloletnike treba da:</p>
---	---	--

